

## VENDIM

Nr .82, date 2.3.2000

### PER SHPALLJEN PARK KOMBETAR NE MBROJTJE TE SHTETIT TE ZONES ARKEOLOGJIKE TE BUTRINTIT

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes, me propozimin e ministritte Kultures, Rinise dhe Sporteve, Keshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

1. Shpalljen Park Kombetar ne mbrojtje te shtetit, zonen arkeologjike te Butrintit, me sipërfaqe 25 km<sup>2</sup>, te shtrire ne keta kufij gjeografike: Ne veri kufizohet me fshatin Ksamil;  
Ne jug me lumin e Pavllos, duke anashkaluar Vrinen, drejt fushes dhe duke u futur brenda zones te liqeni i Bufit;  
Ne perendim me gjirin e Butrintit, aty ku kanali i Vivarit derdhet ne det;  
Ne lindje me rrugen ekzistuese, qe shkon ne Konispol (sipas hartes qe i bashkelidhet vendimit) .
2. Per administrimin e ketij Parku Kombetar ngarkohet Zyra e Administrimit dhe Koordinimit, e qytetit antik te Butrintit, njesi nen Juridiksionin e Ministrise se Kultures, Rinise dhe Sporteve.
3. Ky vendim nuk cenon afatet e parashikuara per realizimin e projektit turistik brendashkruar kufijve, te percaktuar ne piken 1 te ketij vendimi.
4. Ngarkohet Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve per zbatimin e ketij vendimi. Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta